

**National
Literacy
Trust**

Change your story



E
përshatshme
për familjet
me fëmijë të
moshës
0-9 muaj.

Historia e tyre fillon me ju

Duke l folur dhe duke e dëgjuar fëmijën tuaj e ndihmon atë në ndërtimin e aftësisve të tij komunikuese që në fillim.

Përdorni këto karta për të shfrytëzuar në maksimum momentet e vogla të përditshme së bashku.

Në partneritet me

**Better
Health**
Start
for Life



Procesi i veshjes

Kur jeni duke e veshur fëmijën tuaj, përshkrimi i asaj që po ndodh i ndihmon ata të fillojnë të njohin fjalët.

Këshilla për të biseduar gjatë procesit të veshjes:

Flisni për atë që jeni duke bërë.


"Hajde të vishemi, fillimisht vendosim pelenën."

Flisni për rrobat që jeni duke l veshur.

"Sot do të veshësh pantallona me vija."

Përsëritni të njëjtat fjalë çdo ditë.

"Një krah brenda në pallto, të dy krahet brenda palltos."





Orari i vakteve

Kur jeni duke ushqyer fëmijën tuaj, krijimi i bisedave ose këndimi i ndihmon ata të fillojnë të kuptojnë domethënien e fjalëve.

Këshilla për të biseduar gjatë vakteve

Përshkruani se çfarë po ndodh.

"Tani ti po pi qumështin"

Këndoni një rimë ose këngë për fëmijë.

"Maria kishte një qengji të vogël, një qengji të vogël ..."

Flisni për atë që do të ndodhë më pas.

"Pasi të pish qumështin, ne do të shkojmë për një shëtitje"





Në shtëpi

Duke biseduar me fëmijën tuaj për atë që po bëni nëpër shtëpi, ai do të familjarizohet me fjalët që ju përdorni.

Këshilla për të biseduar në shtëpi

Përshkruani atë që po bëni.

"Babi po i vendos rrobat në lavatrice."

Flisni për atë që femija është duke bërë dhe përgjigjuni tingujve që bëjnë.

"Të shoh që po buzëqesh ba-ba-ba"

Flisni për zhurma dhe tinguj që janë të njohur për fëmijën tuaj.

"A e dëgjon zhurmën që bën lavatriceja? Swish swish!"





Jashtë shtëpisë

Ndërsa jeni jashtë, të folurit për gjërat që shikoni do ta ndihmojë fëmijën tuaj të mësojë fjalë të reja.

Këshilla për të biseduar kur jeni jashtë:

Flisni për atë që shihni.

"Shiko macen e zezë! Ajo është fshetur atje poshtë."

Flisni për gjërat që fëmija juaj shikon.

"Ti po shikon lulet" Le t'i shohim më nga afër.

Përdorni shqisat tuaja për të nxitur biseda.

"A e dëgjon zhurmën e makinës? Brum, brum."





Koha për tu larë

Kur jeni duke larë fëmijën tuaj,
kopjimi i tingujve që ai lëshon e
inkurajon atë të komunikojnë.

Këshilla për të biseduar gjatë larjes

Përkruani zhurmën që
bën uji.

*"A po spërkat?
Splash splash!"*

Fisni për atë që jeni duke bërë.

"Tani do të laj barkun"

Përgjigjuni dhe përsëritni
zhurmat që fëmija juaj bën.
Fëmija: "Eeeee ...ba, ba, ba"
I rrituri: "Ba, ba, ba, a po flet
me mua?"





Orë e gjumit

Kur bisedoni, tregoni histori dhe këndoni së bashku para gjumit, në këtë mënyrë ju e prezantoni fëmijën tuaj me fjalë të reja.

Këshilla për të biseduar para gjumit

Vini re se në cilën pjesë të librit është duke parë ose prekur.

"Po, kjo është një makinë"

Provoni të këndoni një këngë për fëmijë ose një ninullë.

"Ndrico, ndrico yll I vogël..."

Bisedoni për atë që ka ndodhur gjatë ditës.

"Sot u ftohëm gjatë shetitjes tonë."



Këtu janë këshillat tona të preferuara për të ndihmuar fëmijën tuaj që të komunikojë:

- Bisedoni me fëmijën tuaj duke iu përgjigjur belbëzimeve, zhurmave, shprehjeve të fytirës dhe lëvizjeve që ai bën. Mos harroni që duhet të ndaloni dhe t'u jepni atyre kohë për t'u përgjigjur kur ju l flisni.
- Shikoni me kujdes se çfarë po ju tregojnë dhe ku po shikojnë, për të mësuar se çfarë u intereson, pastaj bisedoni me ta rreth atyre gjërave.
- Gjeneroni mundësi për të folur, kënduar dhe luajtur gjatë gjithë ditës.
- Kur ju shfrytëzoni sa më shumë momentet e vogla duke qënë bashku, ju e ndihmoni në ndërtimin e aftësive komunikuese të fëmijës tuaj që në fillim.

Ky produkt nuk është i lodër.



@Literacy_Trust



@Literacy_Trust

Për më shumë aktivitete, ju lutemi, vizitoni [wordsforlife.org.uk](https://www.wordsforlife.org.uk)

National Literacy Trust është një organizatë britanike e regjistruar nr. 116260 (Angli dhe Uelisi) dhe SC042944 (Skoci).